

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Luljeta Susuri procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve: M. (D.) I.1 dhe T. I. që të dy nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, M. (M.) I.2, M. I.1, M. I.3 dhe Sh. I. që të gjithë nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1633/2015 të datës 04.11.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike në praninë e prokurorit të shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarve, me datë 01.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

**M. I.1** nga i ati D. dhe e ëma S. e lindur T., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme, kuzhinier, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**T. I.** nga i ati D. dhe e ëma S. e lindur T., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**M. I.2** nga i ati M. dhe e ëma Sh. e lindur K., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr... ka të kryer shkollën e mesme, depoist, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**M. I.3** nga i ati H. dhe e ëma H. e lindur Z., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr... ka të kryer shkollën e mesme, kuzhinier, i martuar, baba i tre fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**M. I.4** nga i ati M. dhe e ëma Sh. e lindur K., e lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme, amvise, e pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e gjendjes së varfër ekonomike.

**SH. I.** nga i ati S. dhe e ëma Xh. e lindur R., e lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, amvise, e martuar, nënë e tre fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, boshnjake, shtetase e Republikës së Kosovës, e gjendjes së varfër ekonomike.

**JANË FAJTOR**

## **Të akuzuarit M. I. dhe T. I.**

1. Me datë 22.10.2014 rreth orës 20:00, në Prizren rrugën ... shkaktojnë lëndime trupore të akuzuarve M. (M.) I.2, M. I.3, M. I.4 dhe Sh. I., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes familjare lidhur me ndryshimin e emrit të akuzuarit M. (D.) I.1 i cili në parë ka pasur emrin A., i akuzuari M. I.3 dhe M. (M.) I.2, shkojnë për të takuar dhe për tu marrë vesh me djalin e axhës lidhur me këtë ndryshim, me ç'rast situata acarohet dhe më pas fillojnë të godasin njëri tjetrin me mjete të forta, ashtu që ndërhyjnë edhe i akuzuari T. I., më pas kësaj rrëmuje i bashkohen edhe të akuzuarat M. I.4 dhe Sh. I., me ç'rast si pasojë e përlëshjes lëndime trupore pësojnë i akuzuari M. I.3 dhe atë: plagë qarëse dhe shqyese të indeve të buta në regjionin tëmthor të kokës, në veshin e majtë gërvishtje lëkurore të regjionit ballor të kokës dhe në regjionin e fytyrës, i akuzuari M. (M.) I.2, pëson plagë qarëse dhe shqyese të indeve të buta në regjionin zverkor të kokës dhe gishtit të pestë të shuplakës së dorës së djathtë, gërvishtje lëkurore në regjionin e kafazit të kraharorit dhe në dorën e majtë, e akuzuara M. I.4 pëson ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe gjak mbledhje nën lëkurore në regjionin e fytyrës dhe e akuzuara Sh. I. pëson ndrydhje me plagë qarëse-shqyese të indeve të buta në regjionin tëmthor të kokës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

**Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK.**

## **Të akuzuarit M. (M.) I.2, M. I.3, M. I.4 dhe Sh. I.**

2. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë e përshkruar si në dispozitivin nën I. të aktgjykimit, për shkak të ngatërresave familjare lidhur me ndërrimin e emrit, derisa ishin duke u përlëshur, me dashje përdorin forcë ndaj djemve të xhaxhait të tyre, kështu të akuzuarit bashkërisht e sulmojnë fizikisht të akuzuarit M. (D.) I.1 dhe T. I., ashtu që të njëjtit e godasin me mjete të forta në pjesë të ndryshme të trupit pa dashjen e tyre, mirëpo nuk i shkaktojnë lëndime trupore.

**Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 dhe nenit 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK të akuzuarve iu shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit **M. (D.) I.1** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit **T. I.** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit **M. (M.) I.2** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit **M. I.3** vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarës **M. I.4** vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarës **Sh. I.** vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Obligohen të akuzuarit M. (D.) I.1, T. I., M. (M.) I.2, dhe M. I.3 në mënyrë solidare të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të ekspertizës për ekspertin e mjekësisë ligjore shumë prej 50 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili prej tyre veç e veç të paguaj shumë prej nga 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Të akuzuarat M. I.4 dhe Sh. I. janë të gjendjes së varfër ekonomike – janë pa punë, prandaj lirohen nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarave.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht e bënë Shërbimi Sprovues në Prizren, në kuptim të nenit 150 të LESP.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1633/2015 të datës 04.11.2016 kundër të akuzuarve: M. (D.) I.1 dhe T. I. që të dy nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, Muhamed (Murat) Idrizi, M. I.3, M. I.4 dhe Sh. I. që të gjithë nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarve. Të akuzuarit pas kësaj deklarojnë se e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshtojnë provat materiale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 22.20.2014 rreth orës 20:00, në Prizren në rrugën ... të akuzuarit M. (D.) I.1 dhe T. I., për shkak të problemeve familjare, rreth ndërrimit të emrit të akuzuarit nga emri 1A. në atë M., i akuzuari M. I.3 dhe M. (M.) I.2, shkojnë për të takuar me djalin e axhës lidhur me ndërrimin e emrit, me ç'rast situata acarohet dhe më pas fillojnë të godasin njëri tjetrin me mjete të forta, ashtu që ndërhyjnë edhe i akuzuari T. I., më pas kësaj rrëmuje i bashkohen edhe të akuzuarat M. I.4 dhe Sh. I. me ç'rast si pasojë e përleshjes lëndime trupore pësojnë i akuzuari M. I.3 dhe atë: plagë qarëse dhe shqyese të indeve të buta në regjionin tëmthor të kokës, në veshin e majtë gërvishtje lëkurore të regjionit ballor të kokës dhe në regjionin e fytyrës, i akuzuari M. (M.) I. pëson

plagë qarëse dhe shqyese të indeve të buta në regjionin zverkor të kokës dhe gishtit të pestë të shuplakës së dorës së djathtë, gërvishtje lëkurore në regjionin e kafazit të kraharorit dhe në dorën e majtë, e akuzuara M. I.4 pëson ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe gjak mbledhje nën lëkurore në regjionin e fytyrës dhe e akuzuara Sh. I. pëson ndrydhje me plagë qarëse-shqyese të indeve të buta në regjionin tëmthor të kokës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Në këtë rrëmuje bashkërisht të akuzuarit M. (M.) I.2, M. I.3, M. I.4 dhe Sh. I., në gjendje të revoltuar derisa ishin duke u përleshur, me dashje përdorin forcë ndaj djemve të xhaxhait të tyre, sulmojnë fizikisht të akuzuarit M. (D.) I.1 dhe T. I., ashtu që të njëjtit e godasin me mjete të forta në pjesë të ndryshme të trupit pa dashjen e tyre, mirëpo nuk i shkaktojnë lëndime trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar në shqyrtimin fillestar, për faktin se të akuzuarit vullnetarisht kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Mirëpo sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekzistojnë prova të pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë, të cilat mbështeten në fakte dhe prova materiale. Të akuzuarit me kohë janë njoftuar me të gjitha provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza, andaj ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarve M. (D.) I.1 dhe T. I. formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK. Ndërsa në veprimet e akuzuarve M. (M.) I.2, M.3 I., M. I.4 dhe Sh. I. formohen të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoj dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve, rrethanat familjare – janë familjar, pendimi i thellë për kryerjen e veprave penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahen nga veprimet e këtilla, kjo është hera e parë që bien ndesh me ligjin, andaj gjykata iu shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj të akuzuarve iu shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryejnë veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2417/2016 të datës 01.11.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Luljeta Susuri**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.